

25.02.2022
Ora 18:10

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022".

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|--------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, E. Meta, A. Tahiraj |
| Parti | Politike: | LSI (A. Kaziaj) |

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma kolegë! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, përfaqësues të subjekteve zgjedhore, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi një projektvendim "Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.02.2022*

dhe Lushnje që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”. Paraprakisht të pyes kolegët dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës, të cilën duan ta diskutojnë, kolegë? Zoti Kaziaj? Faleminderit! Atëherë, fillojmë me rendin e ditës me shqyrtimin e projektvendimit, i cili ka ardhur në Komisionin Rregullator, me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sigurisht ky udhëzues i punës vjen pas miratimit disa ditë më parë të një vendimi nga ana e Komisionit Rregullator, dhe gjithashtu do të shërbejë si bazë për trajnimet e anëtarëve të KZAZ-ve dhe grupeve të numërimit të votave, trajnime që do të zhvillohen në kuadër të zgjedhjeve të datës 6 Mars 2022, në 6 bashkitë, ku do të zhvillohen zgjedhjet për kryetar. Ftoj Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së, zotin Merkaj, të bëjë një prezantim të shkurtër të projektvendimit. Zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Në nenin 20 të Kodit Zgjedhor përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, udhëzuesit, doracakët e shërbimit të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve. Referuar për sa më sipër kemi përgatitur projektvendimin “Për miratimin e udhëzimit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datën 6 Mars 2022”. Ky udhëzim është një material në ndihmë të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe grupeve të numërimit të votave. Në këtë udhëzim janë përmbledhur aspektet themelore të funksionimit dhe detyrave të KZAZ-ve në lidhje me procesin e numërimit të votave. Udhëzuesi është hartuar specifikisht për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Ky udhëzues fokusohet në detyrat që ka KZAZ-ja lidhur me ngritjen e grupeve të numërimit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.02.2022*

dhe veprimtarinë e saj në numërimin e votave. Udhëzuesi është konceptuar që nga momenti i detyrave të KZAZ-së për organizimin e VNV-së, ngritjen e grupeve të numërimit të votave, marrjen e materialeve zgjedhore nga KQV-ja, si dhe përmes krijimit të grupeve të marrjes në dorëzim të këtyre materialeve, procesi i numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit, si dhe dërgimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në udhëzues janë trajtuar dhe çështje të natyrës së përgjithshme, si rregullat e etikës të zbatueshme në kushtet e pandemisë. Në udhëzues janë evidentuar rregulla të përgjithshme, të cilat duhet të zbatohen në vendin e numërimit të votave, duke përcaktuar individë, të cilët janë të lejuar të jenë për të ndjekur procedurat e numërimit të votave, dokumentet e identifikimit të tyre, si dhe mënyrën sesi KZAZ-ja verifikon këto dokumente. Në detyrat e KZAZ-së për ngritjen e grupeve të numërimit të votave janë përcaktuar dhe veprimet paraprake për ngritjen e grupeve të numërimit të votave, si dhe ngritjen e tyre me përbërjet përkatëse për çdo grup numërimi. Udhëzuesi është ndaluar edhe në rastin se kur hapet kutia e materialeve zgjedhore dhe veprimet që kryhen me kutinë e materialeve zgjedhore, gjithashtu është parashikuar mënyra e nxjerrjes së tabelave përmbledhëse për kandidatët për kryetar bashkie, si dhe transmetimet elektronike të këtyre rezultateve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Së pari e shqyrtojmë në parim dhe më tej e votojmë në parim. Kolegë, nëse ka dikush diçka lidhur me projektvendimin në parim? Unë personalisht do doja të theksoja diçka, faktin që ky është një vendim i posaçëm për këto zgjedhje, për shkak se këto zgjedhje kanë specifikën e tyre pra, votohet vetëm për kryetar në 6 bashki. Kështu që dhe puna e grupeve të numërimit në vendet e numërimit të votave dhe nxjerrja e rezultateve më tej nga komisionet e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.02.2022*

zonave të administrimit zgjedhor fokusohet vetëm tek kryetarët, që në vlerësimin tim do të thotë një punë më e thjeshtë në raport me zgjedhjet vendore të përgjithshme, ku votohet dhe për anëtarë të këshillave bashkiakë, apo edhe në raport me punën për zgjedhjet për Kuvend, ku kishim votimin dhe numërimin qoftë për subjektet, qoftë për kandidatët. Kjo mund të çojë edhe në një nxjerrje më të shpejtë të rezultatit, kështu që administrata e cila është përgjegjëse dhe për trajnimet është e pranishme dhe ndoshta edhe ky mesazh i një pune të shpejtë, do të duhet të përcillet gjatë trajnimeve që do të bëni me anëtarët e grupeve të numërimit të votave, apo dhe të KZAZ-ve. Nga subjektet zgjedhore, zoti Kaziaj, ka diçka në parim lidhur me projektvendimin?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i SH-L-së: Jo, përveç faktit që ndaj dhe unë atë që sapo thatë dhe ju, është një projektvendim, të themi, klasik, i cili duhet posaçërisht për këto zgjedhje dhe ndaj në përgjithësi atë që thatë ju. Nuk kam ndonjë shtesë apo ndryshim lidhur me të.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Kaziaj! Atëherë kolegë nëse nuk ka diskutime në parim, diskutime të tjera, ju ftoj të votojmë në parim projektvendimin.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Ka 3 pika ky vendim. Fillojmë me të parën. Komisioni Rregullator vendosi:

1.Të miratojë udhëzuesin e punës për komisionet e zonave të administrimit zgjedhor dhe grupet e numërimit të votave, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më 6 Mars 2022, bashkëlidhur këtij vendimi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.02.2022*

Kështu që do duhet të kalojmë në tekstin bashkëlidhur vendimit, pra që është udhëzuesi, sikundër zoti Merkaj e theksoi, është i ndarë në disa pjesë dhe do t'i trajtojmë me radhë, në mënyrë që nëse ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët, apo nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, t'i referohemi konkretisht pjesës konkrete dhe vendit ku ndodhet në tekst. Fillojmë me tabelën e përmbajtjes, e cila mungon, do t'i luteshim administratës gjatë zbardhjes ta reflektojë.

Kalojmë tek Kreu I. Rregullat e etikës. Kemi diçka?

Tek Kreu II. Rregulla në kushtet e pandemisë Covid?

Kreu III. Detyra të KZAZ-së për organizimin e VNV-ve?

Kreu IV. Rregulla në vendin e numërimit të votave?

Kreu V. Detyra të KZAZ-së për ngritjen e grupeve të numërimit të votave?

Kreu VI. Detyrat të KZAZ-së për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore?

Kreu VII. Detyra të KZAZ-së për numërimin?

Kreu VIII. Hapja e kutisë së materialeve të votimit?

Kreu IX. Transmetimi elektronik i rezultateve paraprake dhe nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkie?

Kreu X. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar bashkie nga KZAZ-të?

Kreu XI. Dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ.

Kreu XII. Procesi i votimit dhe numërimit në Bashkinë Vorë. Unë këtu kam vetëm një sugjerim të vogël. Duke qenë që jemi në kushtet e udhëzuesit për KZAZ-të, GNV-të, le ta lëmë “procesi i numërimit”, se votimi është një proces që është kryer në këtë fazë. Pra, “procesi i numërimit për Bashkinë Vorë”, duke qenë që Bashkia Vorë është bashkia që tashmë është përzgjedhur dhe për të cilën janë marrë vendimet përkatëse për aplikimin e votimit elektronik. Po dhe një sugjerim nga zonja Vukaj, pikërisht në këtë kre, në faqen e fundit. Procesi i nxjerrjes së rezultateve për çdo QV dhe në rang bashkie realizohet nga KZAZ. KZAZ-ja kryen procesin e numërimit të votave në sistemin elektronik të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.02.2022*

menaxhimit të votimit dhe rezultateve apo nëpërmjet? Nëpërmjet, në rregull! Gjithashtu unë do të sugjeroja që gjatë trajnimeve, këtij udhëzuesi t'i bashkëlidhen edhe modelet e fletëve të votimit, të cilat më herët, në vendimin tonë i kemi miratuar që janë për orientimin e grupeve të numërimit të votave për të vlerësuar votat e vlefshme dhe të pavlefshme. Atëherë duke qenë se për të gjithë krerët e projektudhëzuesit nuk kishim ndonjë vërejtje apo ndonjë propozim për shtesë apo ndryshim, përveç disa saktësimeve të vogla, ftoj kolegët të miratojmë pikën 1 të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi e kemi votuar atë në parim dhe nen për nen, edhe njëherë ju lutem kolegë, dakordësinë ose jo tuajën, lidhur me projektvendimin në tërësi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.25.02.2022*

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Sikundër thamë në fillim nuk kemi pikë tjetër në rendin e ditës. Me miratimin e këtij vendimi e deklaroj mbledhjen të mbyllur. Natën e mirë!

Vendim nr. 23

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

